

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - kolegji i përbërë nga gjyqtarët Valdete Daka, kryetare e kolegjit, Agim Maliqi dhe Nesrin Lushta, anëtarë, me bashkëpunëtoren profesionale Qefsere Berisha, procesmbajtëse, në çështjen penale kundër të dënuarit H.Sh, për shkak të veprave penale vrasja, nga neni 178 të KPRK-së dhe mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve, nga neni 374 par.1 të KPRK-së, duke vendosur përkitazi me kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë të paraqitur nga mbrojtësi i të dënuarit av. M.K, kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Krime të Rënda PKR.nr.509/2016 të datës 03.04.2018 dhe aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës PAKR.nr.267/2018 të datës 05.07.2018, në seancën e kolegjit të mbajtur më 11 nëntor 2018, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë e mbrojtësit të të dënuarit H.Sh, e paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Krime të Rënda PKR.nr.509/2016 të datës 03.04.2018 dhe aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës PAKR.nr.267/2018 të datës 05.07.2018.

A r s y e t i m

Vendimi i Gjykatës Themelore

Gjykata Themelore në Prishtinë - Departamenti për Krime të Rënda, me aktgjykimin PKR.nr.509/2016 e datës 03.04.2018, të dënuarin H.Sh, e ka shpallur fajtor për veprat penale vrasja, nga neni 178 të KPRK-së dhe mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve, nga neni 374 par.1 të KPRK-së dhe e ka gjykuar me dënim unik burgimi në kohëzgjatje prej 5 (pesë) vite e 6 (gjashtë) muaj, në të cilin dënim i është llogaritur koha e kaluar në paraburgim prej datës 16.09.2015 e tutje. I është shqiptuar dënimi plotësues konfiskimi i armës

së tipit TT 33 e kalibrit 7.65 mm dhe 58 fishekë të të njëjtit kalibër. Është obliguar në pagesën e paushallit gjyqësor në shumë prej nga 200 (dyqind) €, kurse përfaqësuesi i të dëmtuarit nuk ka paraqitur kërkesë pasurore juridike.

Vendimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës

Gjykata e Apelit e Kosovës, me aktgjykimin PAKR.nr.267/2018 e datës 05.07.2018, ka aprovuar si të bazuar ankesën e Prokurorisë Themelore në Prishtinë dhe ka ndryshuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë përkitazi me vendimin mbi dënimin dhe për veprat penale për të cilat i dënuari është shpallur fajtor dhe i është shqiptuar dënim unik burgimi në kohëzgjatje prej 9 (nëntë) vite e 6 (gjashtë) muaj, në të cilin dënim është llogaritur koha e kaluar në paraburgim prej datës 16.09.2015 e tutje.

Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë

Kundër këtyre aktgjykimeve kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë ka paraqitur mbrojtësi i të dënuarit, av. M.K. nga P., për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës ta aprovojë si të bazuar kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë, ta anuloj aktgjykimin e gjykatës së shkallës së dytë dhe ta vërtetoj aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë.

Mendimi i Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit

Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit e Kosovës, me shkresën KMLP.II.nr.226/2018 e datës 30.11.2018, ka propozuar që kërkesa të refuzohet si e pabazuar.

Pretendimet e paraqitura në kërkesë

Në kërkesë mbrojtësi i të dënuarit thekson se me aktgjykimin e gjykatës së shkallës së dytë është ndryshuar aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë dhe të dënuarit i është rrit dënimi për katër vite burgim dhe me këtë rast janë shkelur të drejtat e të dënuarit, meqë aktgjykimin të gjykatës së shkallës së dytë i mungon arsyetimi përkitazi me rritjen e dënimit.

Gjykata e shkallës së dytë, duke vepruar sipas ankesës së prokurorit të shtetit, ka aprovuar ankesën e saj edhe pse në ankesë vetëm janë parafrazuar dispozitat ligjore dhe është kërkuar dënim më i ashpër pa dhënë arsye bindëse për shkaqet të cilat do të ndikonin në rritjen e dënimit, kurse me këtë rast nuk ka pasur parasysh pretendimet e të dënuarit të paraqitura në fjalën e tij përfundimtare dhe posaçërisht faktin e provokimit nga tani i ndjeri përkatësisht faktin se i ndjeri e kishte sulmuar paraprakisht me kamionin e tij të dënuarin. Po ashtu gjykata e shkallës së dytë nuk ka pasur parasysh aspekte tjera që i kanë parapri ngjarjes kritike se nga ana e viktimës për një kohë të gjatë ka qenë i cenuar dinjiteti i të dënuarit me kërkesa për pagesën e mjeteve monetare.

Pretendohet se aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë i mungon arsyetimi dhe me këtë rast është shkelur dispozita e nenit 370 të KPPK-së, pasi që në aktgjykim nuk ceket se cilat fakte dhe për çfarë arsye i konsideron të vërtetuara apo të pavërtetuara në të cilën është bazuar me rastin e rritjes së dënimit, por është mjaftuar me konstatimin se është fjala për veprë penale me rrezikshmëri shoqërore, kurse i mungon arsyetimi se pse lartësia e dënimit e shqiptuar nga gjykata e shkallës së parë nuk është në harmoni me rrezikshmërinë shoqërore të kësaj veprë penale.

Në kërkesë më tutje pretendohet se gjykata e shkallës së dytë ka shkelur edhe udhëzimet e gjykatës Supreme të Kosovës përkitazi me unifikimin e dënimeve, sepse me këtë rast ka shqiptuar dënimin pothuajse në maksimumin e dënimit të paraparë me dispozitë ligjore dhe nuk ka marrë mesataren e dënimit dhe me këtë rast nuk ka marrë parasysh se i dënuari është person i sëmurë me moshë mbi 70 vjeçar, i cili nuk ka paraqitur rrezik për rrethin, nuk ka rënë ndesh me ligjin, është baba i tetë fëmijëve dhe ditën kritike ka vepruar për ta mbrojtur jetën e tij dhe të bashkëshortes së tij, përkatësisht ka vepruar në mbrojtjen e nevojshme.

Gjetjet e Gjykatës Supreme të Kosovës

Gjykata Supreme e Kosovës në seancën e kolegjit shqyrtoi shkresat e lëndës në kuptim të nenit 435 par.1 lidhur me nenin 436 par.1 të KPPK-së dhe pas vlerësimit të pretendimeve në kërkesë, gjeti se:

kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë nuk është e bazuar.

Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, pretendimi i mbrojtësit të të dënuarit është i pabazuar, ngase me aktgjykimin e gjykatës së shkallës së dytë përkitazi me ashpërsimin e dënimit të shqiptuar nga ana e gjykatës së shkallës së parë janë dhënë arsye të mjaftueshme dhe atë posaçërisht në faqen e tretë të këtij aktgjykimi është potencuar se përkundër rrethanave të konstatuara nga gjykata e shkallës së parë dënimi i shqiptuar është tejet i butë dhe nuk është në harmoni me rrezikshmërinë shoqërore të veprës penale dhe posaçërisht kur kemi të bëjmë me veprë penale të vrasjes. Ashtu që duke marrë parasysh të gjitha rrethanat e rastit konkret dhe rrethanat nën të cilat është kryer vepra penale të dënuarit i është shqiptuar dënimi në harmoni me intensitetin e rrezikshmërisë shoqërore të veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë penale të të dënuarit dhe me bindje se me anë të dënimit të shqiptuar do të arrihet qëllimi ndëshkimor i paraparë me dispozitën e nenit 41 të KPRK-së. Andaj arsyetimin e gjykatës së shkallës së dytë përkitazi me ashpërsimin e dënimit e pranon edhe Gjykata Supreme e Kosovës, pasi që matja e dënimit është në diskrecion të gjykatës dhe nuk mund të konsiderohet si i paligjshëm vlerësimi ndryshe i rrethanave të njëjta nga gjykata e shkallës së dytë.

Sa i përket shkallës së dënimit edhe ky pretendim nuk është i bazuar pasi që nuk qëndron fakti se të dënuarit gjykata e shkallës së dytë i ka shqiptuar dënimin pothuajse në maksimumin e dënimit për këtë veprë penale, pasi që për veprën penale vrasja e paraparë me dispozitën e nenit 178 të KPRK-së, është përcaktuar minimumi i dënimit që është jo më pak se 5 (pesë) vite burgim, kurse dënimi maksimal nuk është përcaktuar e që nënkupton që dënimi maksimal për këtë veprë penale është maksimumi i përgjithshëm i përcaktuar me dispozitën e nenit 45 par.1 të KPRK-së përkatësisht dënim burgimi 25 (njëzete e pesë) vite, ashtu që nuk qëndron pretendimi se gjykata e shkallës së parë ka shqiptuar dënim afër maksimumit të përcaktuar ligjor.

Në kërkesë pretendohet përkitazi me faktin se i dënuari veprën penale e ka kryer duke vepruar në mbrojtje të nevojshme përkatësisht duke e mbrojtur jetën e tij dhe bashkëshortes së tij, mirëpo edhe ky pretendim del të jetë i pabazuar pasi që gjykata e shkallës së parë në faqen e shtatë të arsyetimit të saj thekson se ky pretendim nuk ishte i bazuar dhe për më tepër, nuk ishte vërtetuar me asnjë provë tjetër me përjashtim të mbrojtjes së të dënuarit. Megjithatë këto pretendime të mbrojtjes nuk janë paraqitur në gjykatën e shkallës së dytë pasi që nuk kanë

paraqitur fare ankesë kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë, ashtu që këto pretendime kanë mbetur të pashqyrtuara.

Në kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë, përveç shkeljeve të potencuara, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, janë paraqitur edhe pretendime për konstatimin e gabueshëm dhe jo të plotë të gjendjes faktike. Mirëpo, këto pretendime nuk janë vlerësuar nga Gjykata Supreme e Kosovës, meqë bazuar në dispozitën e nenit 432 par.2 të KPPK-së, kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë nuk mund të ushtrohet për shkak të konstatimit të gabueshëm dhe jo të plotë të gjendjes faktike.

Andaj, në rastin konkret në mënyrë të drejtë dhe të plotë, janë vlerësuar të gjitha rrethanat dhe me këtë drejt është aplikuar ligji penal dhe pretendimi në fjalë nuk ishte i bazuar.

Nga sa u parashtrua më lartë e në kuptim të nenit 437 par.1 të KPPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - PRISHTINË

Pml.nr.320/2018, më 11 nëntor 2018

Procesmbajtësi,
Qefsere Berisha

Kryetarja e kolegjit,
Valdete Daka